

Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

Procesverbali i mbledhjes

Ref. 4/2011

Vendi: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Data: 21 shtator 2011

Koha: 11:00 – 12:10

Pjesëmarrësit:

Robert Wright, Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (*kryesues*)
Arzen Çavdarbasha, Koordinator i Zhvillimeve DSNP, BQK
Masar Baxhaku, Zyrtar i Mbikëqyrjes DSNP, BQK
Diturie Hoxha, Drejtore Ekzekutive, SHBK
Naim Gashi, Menaxher i Thesarit, PTK Sh.A
Akile Cërnobregu, Udhëheqëse e Departamentit të Pagesave, PCB
Teuta Gazideda, Menaxhere e CM&TMO, RBKO
Milot Kelmendi, Menaxher i Performancës dhe Analizës, KEK
Boryana Ivanova Mustafa, Drejtore e Pagesave dhe Thesarit, NLB
Dukagjin Shylemaja, Zëvendës Drejtor, TEB
Eriola Bibolli, ProCredit Bank Kosova
Isen Lipovica, Administrata Tatimore e Kosovës

Munguan:

Gjylfidane Kadrijaj, Drejtore e Sistemeve Ndër-bankare të Pagesave, BQK (*u përfaqësua në takim nga zëvendësi i caktuar për këtë ekip*)

Përfaqësuesit e KUR Prishtina, MPMS, MF/Thesari dhe OEK (munguan pa njoftim paraprak)

Takimi filloi në ora 11:00.

Z. Robert Wright hapi takimin, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, ndërsa Z. Arzen Çavdarbasha bëri prezantimin e anëtarëve të rinj të grupit punues në kuadër të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme.

Diskutimet dhe prezantimet

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Anëtarët miratuan njëzëri procesverbalin e takimit paraprak të mbajtur më 15 qershor 2011.

- **Prezantimi dhe diskutimet lidhur me propozimet e anëtarëve të grupit punues –krijimi i listës së ngushtë për përcjellje të mëtejshme**

Z. Robert Wright bëri prezantimin e propozimeve të ardhura nga bankat dhe institucionet tjera. Së pari u prezantuan propozimet e ardhura nga BQK-ja, të cilat tashmë janë të njohura për anëtarët e grupit nga takimet e mëhershme. Lidhur me fushatat u tha se është çështje individuale e institucioneve. Nga praktikat e vendeve tjera lidhur me caktimin e vlerës maksimale për pagesa në para të gatshme z. Wright theksoi se mund të rregullohet edhe përmes rregulloreve por është më e dëshirueshme të bëhet në bazë të marrëveshjes vullnetare të institucioneve. U propozua që të plotësohen statistikat mbi instrumentet e pagesave me të dhënat për vitin 2010. Pastaj u prezantuan propozimet e ardhura nga Procredit Bankë dhe Raiffeisen Bankë të cilat kishin mjaft gjëra të përbashkëta. U theksua nevoja e zhvillimit të fushatave për vetëdijesimin e qytetarëve për pagesa pa para të gatshme, çështja e financimit mbetet të diskutohet, financimi nga BB u vlerësua si mundësi duke pasur parasysh se edhe VISA është ofruar për përkrahje. Në pritje të përgjigjes nga Master Card. Bankat janë më të vetëdijshme se në stimulimin për pagesa jo cash ndikim kanë edhe tarifat. Kjo mbetet çështje individuale - unifikimi i çmimeve nuk u vlerësua si opsion i pranueshëm.

Në njërin nga propozimet që kishte të bënte me zgjerimin e rrjetit të POS terminaleve, përfaqësuesi i TEB Bankës Z. Dukagjin Shylemaja tha që nuk është vetëm problemi se ka numër të vogël të POS Terminaleve, por problemi më i madh është mënyra se si janë të shpërndarë ata, ku në të shumtën e rasteve kemi koncentrim të madh të tyre vetëm në një vend. Në të kaluarën është tentuar vendosja e POS terminaleve në kompanitë utilitare por nuk ka pasur interes nga këto të fundit.

Përfaqësuesi i KEK-ut bëri prezantimin e propozimeve të tyre. Ai tha që në totalin e pagesave që bëhen në KEK nga konsumatorët e tyre, rreth 85% e pagesave bëhen në para të gatshme, ndërsa pjesa tjetër bëhet përmes bankave. Autorizimet për Debitim Direkt tani mund të nënshkruhen edhe në zyrat regjionale të KEK-ut. Për nivelin e lart të pagesave me para të gatshme përfaqësuesi i KEK-ut përmendi këto arsye:

- Bankat nuk i procesojnë brenda ditës të dhënat e klientëve që kanë bërë pagesa por të nesërmen. Pasi që prirja e klientëve është që pagesat ti kryejnë ditën e fundit, mos procesimi i pagesave brenda ditës mund të qojë deri te shkyçja e klientëve;
- Kategorizimi i klientëve në bazë të pagesave nëpër kategori të ndryshme bënë që klientët për shkak të vonesës së bankës për dërgimin e të dhënave për klientët që kanë paguar, mund ti dëmtojë klientët duke i vendosur në kategori që nuk paguajnë rregullisht;
- Tarifat e ndryshme të aplikuara nga ana e bankave për pagesat që klientët kanë bërë përmes e-bankingut etj.

Përfaqësuesi i KEK-ut në mënyrë eksplicite deklaroi se KEK nuk planifikon dhe nuk do të bëjë reduktimin/mbylljen e arkave.

Në lidhje me vonesat e bankave në dërgimin e pagesave të klientëve që kanë bërë pagesa për KEK-un, z. Dukagjin Shylemaja tha që kjo më shumë është çështje teknike e cila mund të zgjidhet, pasi

që edhe pse pagesat nga ana e bankave në KEK shkojnë me një ditë vonesë, në detajet e transaksioneve është e shënuar data kur është bërë pagesa nga ana e klientit.

Në anën tjetër zonja Boryana Ivanova Mustafa përfaqësuese e NLB Prishtina përmendi rastin e Maqedonisë si një shembull të mirë, ku përmes një web-servisi klientët mund të kenë qasje për kontrollin e gjendjes dhe printimin e faturave për shërbimet e kompanive publike si dhe kryerjen e pagesave të tyre.

Përfaqësuesi i ATK-ës, Z. Isen Lipovica bëri një shpjegim për mundësin e re të cilën e ofron ATK-ja për tatimpaguesit kosovar i cili u mundëson deklarin elektronik atyre për disa nga deklaratat e tyre tatimore. Ai tha që projekti tashmë veçse ka filluar të aplikohet dhe se shumë shpejt do të jetë funksional në mënyrë të plotë për të gjithë tatimpaguesit.

Puna me MPMS lidhur me pagesën e pensioneve është në proces si pjesë e punës së Grupi Punues për Standardizim të Procedimit të Pagave dhe Pensioneve

Z. Robert Wright theksoi nevojën për takim të KKP për të kuptuar se si kjo iniciativë për pagesat jo cash përputhet me strategjinë më gjerë të zhvillimit të sistemit të pagesave

- **Lidhur me VISA dhe MasterCard-dhe ftesa për takimin e ardhshëm**

VISA ka shprehur interesimin dhe ka ofruar përkrahje për projektin, në kuadër të kësaj për takimin e ardhshëm mund të ftohen përfaqësuesit e VISA. U propozua që takimi i radhës të mbahet në fund të këtij viti mundësisht në mes të dhjetorit, para festave të fund-vitit.

Konkluzionet e Takimit dhe Hapat e ardhshëm

- Krijimi i grupit punues në kuadër të ekipit për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme, i cili do të analizojë mundësinë e krijimit të një forme të web-servisit për kompanitë publike ku klientët do të kenë mundësinë të informohen lidhur me faturat e shërbimeve publike të tyre dhe të bëjnë pagesën e faturave të tyre përmes këtij shërbimi.
- Akile Cernobregu, Boryana Ivanova Mustafa dhe Edmond Jashari u caktuan që të bashkërendojnë punën në këtë grup pune i cili do të përfshijë përfaqësues të bankave dhe kompanive të shërbimeve publike. Në takimin e ardhshëm grupi do të informojë ekipin për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme me rezultatet e punës së tyre dhe mundësitë e implementimit të projektit.
- ATK do të njoftojë për implementimin e projektit ueb service - E-filing
- Kontakti me VISA lidhur me ofertën e tyre për përkrahje si dhe kontakti me MasterCard.
- Plotësimi i statistikave mbi instrumentet e pagesave me të dhënat për vitin 2010